



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 19/2015 për kushtet dhe procedurat e ndërrimit të emrit personal si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

## VENDIM

### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR NDËRRIMIN DHE KORIGJIMIN E EMRIT PERSONAL

#### Neni 1

#### Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit personal në përbërje si vijon:

1. Fauz Xhemajli, Shef i Sektorit të Gjendjes Civile, kryesues
2. Burim Gashi, Shef i Sektorit për Administratë të Përgjithshme, anëtar
3. Sedat Hoxha, Zyrtar i Gjendjes Civile, anëtar.

#### Neni 2

#### Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit

1. Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi të shqyrtoj kërkesat e palëve dhe të vendos për ndërrimin e emrit personal konform procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-118 për emrin personal si dhe Udhëzimit Administrativ (MPB) për kushtet dhe procedurat e ndërrimit dhe korrigjimit të emrit personal.
2. Komisioni për punën e vet mbanë procesverbal.
3. Pas miratimit nga Komisioni, vendimet i nënshkruan kryesuesi i Komisionit.

#### Neni 3

#### Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi 1Nr.201-58406 i datës 01.12.2015 si dhe Vendimi 1Nr.201.58406/2 i datës 14.07.2022.

1Nr. 112/02-40903

Lipjan, 02.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

**VENDIM**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR**  
**SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **5,460.00€**, (pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-40897 të datës 02.08.2022, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 26 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin korrik të vitit 2022 me nga 210 euro për secilin rast 26 x 210 =5,460.00€, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI – dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

**Neni 3**

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

INr.400/01-40897  
Lipjan, më 03.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në kërkesën e DKA –së të datës Nr.01-020/04-41390 të datës 04.08.2022, Kryetari i Komunës merr :

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E ÇMIMIT FILLESTAR PËR**  
**SHTIJE E GJEDHEVE**

**Neni 1**  
**Përbërja e Komisionit**

Formohet, Komisioni për vlerësimin dhe përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e dy Gjedheve të cilët gjenden në fermën e Ekonomisë Bujqësore “Adem Gllavica” bazuar në kërkesën e DKA-së të datës 04.08.2022, në përbërje si vijon:

1. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim, Kryesues,
2. Arben Bahtiri, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar

**Neni 2**  
**Detyrat e Komisionit**

Detyrë e Komisionit është që të përcaktojë çmimin fillestar për shitjen e Gjedheve të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi dhe t'i rekomandoj Kryetarit të Komunës çmimin fillestar për shtije.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/04-41390  
Lipjan, më 05.08.2022.

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të për projektin “Mërgata Fest” 2022 Nr.1-453/01-41165 të datës 03.08.2022, Rekomandimit të komisionit vlerësues Nr.1-400/01-41887 të datës 08.08.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ-NË PËR PROJEKTIN**  
**“MËRGATA FEST” 2022**

**Neni 1**

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **25,000.00 €** (njëzet e pesëmijë e euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-në DRINK FUN DANCE “PI KNAQU VALLEZO” për realizimin e aktiviteteve për projektin ditët e mërgatës “Mërgata Fest” për vitin 2022, e cila ka aplikuar sipas Thirtjes publike për aplikim Nr.1-453/01-34876 e datës 04.07.2022, ku gjithë procedura që nga shpallja publike e deri në nxerrjen e këtij Vendimi është zhvilluar konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna “Mërgata Fest” për vitin 2022:

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	OJQ-në DRINK FUN DANCE “PI KNAQU VALLEZO”	25,000.00 €
	Shuma Totale	<b>25,000.00 €</b>

**Neni 2**

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2022 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 3**

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen me Kontratë të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtën do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.400-41887  
Lipjan, më 08.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

### V E N D I M PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS TË OJQ-SË PËRFITUESE TË MËRGATA FEST 2022

#### Neni 1

Me këtë Vendim, **Mergim Oruqi**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës me OJQ-në përfituese të projektit ditët e mërgatës "Mërgata Fest" për vitin 2022.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontratës të OJQ-së si vijon :

Nr.	Emërtimi i OJQ-së
1.	OJQ-në DRINK FUN DANCE "PI KNAQU VALLEZO"

#### Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës së OJQ-së të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

#### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 020/01-42154  
Lipjan, më 09.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS

*Imri Ahmeti*





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 duke u bazuar edhe në Kërkesën e Drejtoratit Komunal për Arsim 1Nr.400/01-42081 të datës 08.08.2022, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSIVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË**  
**BURSË PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK-SHKOLLOR 2022/2023**

**Neni 1**

I Me këtë Vendim CAKTOHET që për vitin akademik 2022/2023 të ndahen 160 (njëqind e gjashtë dhjetë) bursa dhe shuma finaciare për një bursë do të jetë 500 € (pesëqind) euro.

**Neni 2**

OBLIGOHET, Drejtorati për Arsim që menjëherë pas pranimi të këtij Vendimi të përgadisë Thirrjen publike për aplikim, konform kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 dhe të njëjtën ta publikojë në faqen zyrtare të Komunës , në njërën nga gazetatat ditore me tirazh të madh dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

**Neni 3**

Shuma e cekur nga neni 1 i këtij Vendimi do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria e subvencioneve në xhirollogaritë personale të secilit përfitues të zgjedhur.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

1Nr. 400/01-42081  
Lipjan, më 09.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
për Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT VLERËSUES

I.Me këtë Vendim, **zëvendësohet**, anëtari i Komisionit Vlerësues me numrin rendor 5, Armend Rexhepi në cilësinë e ekspertit nga Shoqëria Civile, i caktuar sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit vlerësues 1Nr.020/04-37716 i datës 18.07.2022, dhe në vend të tij caktohet:

– **Bahri Limolli** në cilësinë e ekspertit nga shoqëria civile, i zgjedhur përmes ftesës publike për aplikim .

II.Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport  
Kryesuesit të Komisionit Ramiz Gashi, DKRS  
Bahri Limollit

1Nr.020/04-37716/2  
Lipjan, 15.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në kërkesën e Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim të datës 15.08.2022, Kryetari Komunës merr:

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E ZYRTAREVE MONITORUESE TË ZONËS EKONOMIKE -**  
**PARKUT INDUSTRIAL NË QYLAGË**

I.Me këtë Vendim sipas kërkesës së Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim të datës 15.08.2022, **CAKTOHEN**, Zyrtare monitoruese për Zonën Ekonomike në Qylagë, zyrtaret komunale si vijon:

1. Shehide Sopa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim
2. Fitore Buja, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim

II.Zyrtaret e lartëcekura do të bëjnë monitorimin dhe mbajtjen e kontakteve me bizneset brenda ZE Qylagë të cilat biznese, do të vendosen në këtë zonë pas përfundimit të procedurave të konkursit publik përkatësisht nënshkrimit të kontratave me Komunën e Lipjanit.

II.Zyrtaret e lartëcekura për punën e tyre do ti raportojnë Drejtorit të Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim.

III.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtori i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyrtaret e lartëcekura.

1Nr. 300/01-43505  
Lipjan, më 16.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES**

**Neni 1**

Formohet, grupi punues për krijimin -zhvillimin e një "databaze" për Komunën e Lipjanit e cila do të mbështetet nga Organizata Helvetas projekti DEMOS, në përbërje si vijon:

1. Islam Kaleshi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
2. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtare
4. Teuta Berisha, Drejtorati për Arsim, anëtare
5. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
6. Fjolla Ibrahim, Qendra për Punë Sociale, anëtare
7. Gjyste Dabaj, Drejtorati për Administratë, NJDNJ dhe barazi gjinore, anëtare
8. Bukuriye Zejnullahu, Zyra për Informim, anëtare
9. Lidija Jovanovic, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
10. Bekim Krasniqi OJQ "YHR", anëtar

**Neni 2**

Grupi punues ka për detyrë që në koordinim me Organizatën Helvetas të krijojë-zhvillojë një "databazë" për Komunën e Lipjanit me qëllim të lehtësimit të procesit të konsultimeve publike si dhe do të ndihmojë në përfshirjen më të madhe të qytetarëve e në veçanti grupeve të marginalizuara në proceset vendimarrëse në nivel lokal.

Drejtoratet tjera komunale të cilat nuk janë të përfshira –përfaqësuar me anëtarë në kuadër të grupit punues do të mbështesin procesin e punës në identifikimin e grupeve të qytetarëve se dhe popullimin e bazës së të dhënave.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Organizata Helvetas dhe dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/04-44734  
Lipjan, më 18.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të për projektin “Plani i Veprimit Rinor Lokal 2022-2024” Nr.5-453/01-43790 të datës 15.08.2022, Rekomandimit të komisionit vlerësues Nr.1-453/01-45453 të datës 22.08.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PROJEKTIN “PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL 2022-2024”**

**Neni 1**

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **36,000.00 €** (tridhjetë e gjashtë mijë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-në YAHR për realizimin e aktiviteteve për projektin Plani i Veprimit Rinor Lokal 2022-2024, e cila ka aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-400/01-22960 e datës 06.05.2022, ku procedura nga shpallja publike e deri në nxerrjen e këtij Vendimi është zhvilluar konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna “Plani i Veprimit Rinor Lokal 2022-2024”:

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	OJQ-në “YAHR”	36,000.00 €
	Shuma Totale	<b>36,000.00 €</b>

**Neni 2**

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2022 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 3**

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen me Kontratë të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-45453  
Lipjan, më 23.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

